REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr._____prot Datë më, __/__/2024

SHPALLJE PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN SPECIALIST FIZIOTERAPIST NË QENDRËN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR (PAK), BASHKIA LUSHNJE

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015"Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 63 , Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" , Strukturës organizative, Bashkia Lushnje shpall konkurimin për vendin e lirë të punës në pozicionin: Specialist Fizioterapist , kategoria III-b, Bashkia Lushnje.

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës;

1. Fizioterapisti në këtë vend pune është përgjegjës për dhënien e shërbimeve fizioterapeutike për persona me aftësi të kufizuara.
2. Kryen ndërhyrje fizioterapie për fëmijët me aftësi të kufizuara .
3. Këshillon/edukon si të menaxhojnë, minimizojnë riskun e dëmtimit (gjatë lëvizjes) dhe si të parandalojnë e përmirësojnë gjendjen fizike të tij.
4. Në bashkëpunim me ekipin shkëmben informacion për backgroundin dhe progresin si dhe referon tek shërbime komunitare që kanë nevojë për vëmendje mjekësore që lidhet me këtë fushë.

KUSHTET DHE KRITERET ;

- Kandidati që aplikon duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë ;
4. Niveli i edukimit Bachelor/Master Profesional/Shkencor;
5. Të ketë eksperiencë pune në profesion;
6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
7. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

-Kandidatët duhet të paraqesinkëro dokumente :

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 22.07.2024 pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE